



Në bazë të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neni 11, 12, 40, Ligjit Nr. 08/L-260 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, neni 3, paragrafi 1.33, neni 16 paragrafi 11, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datën 30.07.2024 merr këtë:

## VENDIM

### PËR PLOTËSIM-NDRYSHIMIN E VENDIMIT 01/5243/2024 PËR RIALOKIMIN E MJETEVE NË KATEGORINË BUXHETORE INVESTIME KAPITALE

1. Kuvendi i Komunës miratoi kërkesën me nr.**04/6034/2024** të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa për rialokim të mjeteve në kategorinë shpenzime kapitale.
2. Rialokimi i mjeteve në kategorinë shpenzime kapitale është në shumë prej **118,117.66 €**, ku nga fondi (10) në shumë prej 90,215.35 €, nga fondi (21) në shumë prej 15,000.00 € dhe nga fondi (22) në shumë prej 12,902.31 €.

#### Rialokimi i mjeteve në kuadër të kategorisë buxhetore Investime Kapitale

Në kuadër të nën-programit Planifikimi Urban dhe Inspeksioni (66480), kodi funksional (0620),  
fondi (10).

#### Rialokohen nga projektet:

- “Mjete të lira për bashkinvestime”, kodi (41641) shuma prej 10,000.00 €, fondi burimor (10),  
“Ndërtimi i mbikalimeve në Rr. Martirët Bushi dhe Rr. Lepenci”, kodi (53429), në shumë prej 15,000.00 €  
fondi burimor (10),  
“Rregulimi i hapësirave publike (me kubëza betoni dhe gjelbërim) ne rr.Dëshmorët e Kombit, Isa Berisha në Har  
të Elezit dhe rr.Gafur Loku-fsh.Paldenicë”, kodi (55043), në shumë prej 12,000.00 €, fondi burimor (10),  
“Fabrika e ujit nga ujësjellësi i Dimeës, Shtëpia e Kulturës - Imri Curri, Stadiumi i qytetit - Suad Brava-  
Shpronësim” kodi (53902), në shumë prej 22,646.35 €, fondi burimor (10).

#### Rialokohen në projektet:

- “Asfaltimi i rrugës Ekzodi 99 - Hani i Elezit”, kodi (55037) në shumë prej 13,531.00 €, fondi burimor (10),  
“Asfaltimi i rrugës “Nehat Curri”, lagja Curri - Dromjak”, kodi (55048), në shumë prej 24,115.35 €, fondi  
burimor (10),  
“Ndërtimi (rihapja, zgjerimi) dhe asfaltimi i rrugëve në fshatrat: Paldenicë, Pustenik, Seçishtë, Gorancë,  
Dimeë, Krivenik.”, kodi (53484), në shumë prej 2,000.00 €, mjetet merren nga fondi (10),

“Ndërtimi i rrugës Nënberg në fshatin Seçishtë”, kodë (55050), në shumë prej 15,000.00 €, mjetet merren nga fondi (10).

“Ndërtimi i mureve mbrojtëse në Lagjen e Re dhe në fshatrat Paldenicë, Dermjak, Seçishtë, Gorancë, Krivenik, Dimcë”, kodë (52894), në shumë prej 5,000.00 €, mjetet merren nga fondi (10).

Në kuadër të nën-programit Administrata – Hani i Elezit (92175), kodë funksional (0980), fondi (10).

**Rialokohen nga projektet:**

- “Pajisja me gjenerator në Qendrën Kulturore “Imri Curri” (54722), në shumë prej 20,000.00 € nga fondi burimor (10).
- “Ndërtimi i objektit të SHFMU në Lagjen e Re”, (52945) në shumë prej 15,569.00 €, fondi burimor (10).

**Rialokohen në projektin:**

- “Rregullimi i infrastrukturës shkollore në SHML – Dardania, SHFMU – Ilaz Thaçi, SHFMU – Kështjella e Diturisë dhe SHFMU – Veli Ballazhi, (53774) në shumë prej 35,569.00 € nga fondi burimor (10).

Në kuadër të nën-programit Planifikimi Urban dhe Inspeksioni (66480), kodë funksional (0620), fondi (21).

**Rialokohen nga projekti:**

“Ndërtimi i mbikalimeve në Rr. Martirët Bushi dhe Rr. Lepenci”, kodë (53429), në shumë prej 15,000.00 €, fondi burimor (21).

**Rialokohet në projektin:**

“Asfaltimi i rrugës “Nehat Curri”, lagja Curri - Dromjak”, kodë (55048), në shumë prej 15,000.00 €, fondi burimor (21).

Në kuadër të nën-programit Parandalimi dhe Inspektimi i Zjarreve (18444), kodë funksional (0320), fondi (22).

**Rialokohen nga projektet:**

1. “Rregullimi i kanalit të ujitjes në vendin Lloka në Seçishtë”, kodë (51616), shuma prej 501.00 €, fondi burimor (22).
2. “Shtimi i kapaciteteve të ujit dhe vendosja e ujëmatësve në Lagjen e Re dhe në Han të Elezit, kodë (53773), shuma prej 2,401.31 €, fondi burimor (22).



Rialokohen në projektin:

1. “Shtimi i kapaciteteve të ujit në Lagjen e Re dhe në Han të Elezit, kodi (55080), në shumë prek 2,902.31 €, fondi burimor (22).

Në kuadër të nën-programit Planifikimi Urban dhe Inspeksioni (66480), kodi funksional (0620), fondi (22).

**Rialokohen nga projektet:**

“Mjete të lira për bashkinvestime”, kodi (41641) shuma prej 5,000.00, fondi burimor (22).

“Fabrika e ujit nga ujësjellësi i Dimcës, Shtëpia e Kulturës - Imri Curri, Stadiumi i qytetit - Suad Brava-Shpronësim” kodi (53902), në shumë prej 5,000.00 €, fondi burimor (22).

**Rialokohen në projektet:**

“Asfaltimi i rrugës Ekzodi 99 - Hani i Elezit”, kodi (55037), në shumë prej 5,000.00€, fondi burimor (22).

“Ndërtimi i mureve mbrojtëse në Lagjen e Re dhe në fshatrat Paldenicë, Dermjak, Seçishtë, Gorancë, Krivenik, Dimcë”, kodi (52894), në shumë prej 5,000.00 €, fondi burimor (22).

3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë, pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës – MAPL-së, si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të komunës.

**Me këtë vendim njoftohen:**

- Kryetari i Komunës,
- Drejtorët e Drejtorive Komunale,
- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

**Data : 30.07.2024**  
**Hani i Elezit**





01/Nr.6405/2024

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 12.2 shkronja (d), 17 shkronja (s), 40.2 shkronja (h), Statutit të Komunës së Hanit të Elezit Nr. 01/4240/2023, të datës 30.05.2023 neni 13, 13.2, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 30.07.2024 merr:

**V E N D I M**  
**PËR SHPALLJE "QYTETAR NDERI" I KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT**

1. Miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës, me numër 02/Nr.6405/2024 dhe merret vendimi për shpalljen "QYTETAR NDERI" i Komunës së Hanit të Elezit gjenerali, Prof.Dr. Kudusi Lame, për shkak të kontributit të tij si ish Komandant i Divizionit të Kukësit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë për çlirimin e Kosovës dhe për zhvillimin e doktrinës ushtarake dhe trajnimin e gjeneratave të reja të oficerëve, kontributi i tij është i padiskutueshëm. Për këto arsye, është vendosur që gjenerali Prof. Dr. Kudusi Lame të shpallet "Qytetar Nderi" i Komunës së Hanit të Elezit.
2. Me rastin e shpalljes, Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit, do t'i dorëzojë gjeneralit, Prof. Dr. Kudusi Lame, titullin dhe dekoratën "QYTETAR NDERI" i Komunës së Hanit të Elezit dhe do të regjistrohet në regjistrin e bartësve të titullit "Qytetar Nderi" i Komunës së Hanit të Elezit.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit.
4. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit  
Data: 30.07.2024

